



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr./Br.

506/20

Datë/Datum.

17.09.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PRISHTINË - PRISTINA

PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.506/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik NNP “CTA” shpk -Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Engrup” SH.P.K. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes në fshatin Gadime” me nr. të prokurimit: 612-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Lipjan, më datën: 17.09.2020 , mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik NNP “CTA” shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes në fshatin Gadime” me nr. të prokurimit: 612-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Lipjan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Ndërtimi i çerdhes në fshatin Gadime” me nr. të prokurimit: 612-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Lipjan, dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NNP “CTA” shpk – Prishtinë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues NNP "CTA" shpk – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 28.07.2020 me nr. 506/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i çerdhes në fshatin Gadime" me nr. të prokurimit: 612-20-2452-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 6, 7, 59, 60, 61, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 39 pika 39.5 i RROUPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.07.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 10.08.2020 sqaron si në vijim, OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë - ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL LIPJAN - ka përcaktuar kushte dhe kriterë për pjesëmarrje në kundërshtim me LPP-në:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi pika 1 dhe 2

Dhe neni 51 -Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes pika 3.

PRETENDIMI NR.1, Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë - ankues se AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN - komisioni vlerësues dhe pika e cekur në letrën standarde për eliminim të datës 16.07.2020 Se: Tenderi juaj është eliminuar për arsye se të kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional përkatësisht të stafi profesional vendimin apo deklaratën për emërimin e menaxherit e keni në emër të inxhinierit të Diplomuar të ndërtimtarisë-drejtimin konstruktive, ndërsa sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me drejtimin e arkitekturës. Si dhe pretendimi Në si ofertues kemi caktua menaxher të projektit inxhinierin e ndërtimtarisë Zija MORINA qe ka qen një gabim minor qe nuk paraqet devijim të madh sepse në listën e stafit kemi të prezantuar edhe inxhinierin e arkitekturës master të cilin mund ta caktojmë menaxher të projektit.

PËRGJIGJEJE NË PRETËNDIMI NR.1, Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.1 të parashtruar nga OE ankues "CTA" SHPK. Prishtinë, duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që ka pranuar në shqyrtim sqaron se AK - Komuna e Lipjanit në njoftimin për kontratë III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: ka përcaktuar kërkesën 2. Staf i Profesional a) Min. Një Inxhinier i diplomuar i arkitekturës, sistemi 5 vjeçar ose master, Të caktohet edhe si menaxher për këtë projekt, OE "CTA" SHPK ka caktuar menaxher të projektit inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë Zija MORINA dhe thotë se ka qenë një gabim minor që nuk paraqet devijim të madh sepse në listën e stafit kemi të prezantuar edhe inxhinierin e arkitekturës master të cilin mund ta caktojmë menaxher të projektit. Ndërsa sipas kërkesës në njoftimin për kontratë është kërkuar të jetë Inxhinier i diplomuar i arkitekturës Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor nuk qëndron pasi që OE ka caktuar menaxher të projektit staf profesional me profesion në kundërshtim me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar

PRETËNDIMI NR.2, Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë - ankues se AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN - komisioni vlerësues dhe pika e cekur në letër standarde për eliminim të datës 16.07.2020 në të Cilën thuhet se: Tenderi juaj është eliminuar për arsye se të kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional përkatësisht të stafi profesional licencën e gjeodetit e keni me afat të skaduar OE ankues në ankesën thotë se AK nuk ka respektuar RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK Neni 39. Sqarimi i Tenderëve pika 39.5 si dhe Neni 72 të LPP Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

PËRGJIGJEJE NË PRETËNDIMI NR.2, Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.1 të parashtruar nga OE ankues "CTA" SHPK. Prishtinë, duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që ka pranuar në shqyrtim sqaron se AK - Komuna e Lipjanit në njoftimin për kontratë në piken III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: ka përcaktuar kërkesën 2. Staf i Profesional f) Një gjeodet bachelor apo master të jetë i pajisur edhe licence për matje gjeodezike, Dëshmia e kërkuar dokumentare

b) Për stafin profesional nga pika A. deri G. Të dëshmohen me CV të nënshkruar nga vet inxhinieri, diplomat, Kontratat e punës ose para kontrata për këtë projekt, licenca për gjeodet me validitet Siç po shihet AK ka kërkuar për anëtarin e stafit profesional gjeodet, për pos dokumentacionit tjetër dhe licenca për gjeodet të jetë me validitet ndërsa OE - ankues e ka dorëzuar licencën në emër të Muzafer Mustafa - inxhinier i gjeodezisë " LICENCA - për kryejën e matjeve kadastrale Në bazë të vendimit të komisionit

për Licencim nr. L-GJ/299 dt. 27.03.2014, Numri i Licencës 09. Afati i skadimit të Licencës 23.03.2019, ndërsa data e njoftimit për kontratë ka qen 01.06.2020 dhe Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qen data 23.06.2020 koha 14:00:00 kështu qe ka pasur kohe të mjaftueshme për me u pajisur me Licence apo siç pretendon OE -ankues se AK nuk ka respektuar Neni 39. Sqarimi i Tenderëve pika 39.5 RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK si dhe Neni 72 të LPP Dokumentacioni dhe informacioni shtesë. Eksperti shqyrtues mendon se Autoriteti kontraktues ka vepruar në bazë të LPP- së dhe RRUOPP kur mungon licenca mund të kërkohe informata sqaruese por OE -ankues me ofertën e vetë e ka dorëzuar Licencën e cila ka qen me afat të skaduar dhe nuk ka qen e nevojshme të kërkohe me informacione shtese sepse OE dokumentacionin e ka dorëzuar por nuk i ka plotësuar kërkesat e kërkuara nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar

PRETENDIMI NR.3, Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë - ankues se AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN -komisioni vlerësues, se oferta e OE e shpallur fitues nuk i plotëson kriterin e kërkuar të Kapaciteti teknik dhe profesional Në njoftimin për kontratë dhe dosje tenderit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofiroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në shumën prej 370,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrata (në rast të grupit (konzorciumit) lideri duhet ti ketë së paku 60% të kërkesës). Gjatë shikimeve në listën e OE ENGRUP shpk të shpallur fitues kemi hasur në projekte jo të ngjashme të cilat i keni vlerësuar si projekte të ngjashme lidhur me ketë aktivitet të prokurimit ku aktiviteti i prokurimit i përket ndërtimit të lartë ndërsa kontrata prezantuese janë të ndërtimit të ulet.

PËRGJIGJEJE NË PRETENDIMIN NR. 3, Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk qëndron sepse duke analizuar listën e kontratave të prezantuar me ofertë për të cilat operatori ekonomik ankues ka pretendime se janë të ndërtimit të ultë e nuk janë të ndërtimit të lartë siç janë kontrata meremetimet: Renovimi i Objektivit të akomodimit për kompanitë e FSK-së në kazermën në Gjilan në shumën 378,516,99 euro e filluar më 16.10.2017 dhe përfunduar 30.10.2018; Renovimi i Objektivit të Akomodimit D2nëKazermën e FSK-së në Mitrovicë në shumën 328,181,33 Euro e fdluar më 28.08.2017 dhe përfunduar 05.07.2018; Renovimi i ambulancave në Neurologji dhe instalimi i rrjetit me pajisjet e IT në shumën 105,310.70 euro e fdluar me 23.07.2019 dhe përfunduar 30.11.2019 dhe disa kontrata tjera të përshkruara në listë janë kontrata të ndërtimit të lartë dhe janë projekte të ngjashme. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar

PRETENDIMI NR.4, Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë - ankues se AK -

KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN - komisioni vlerësues , se oferta e OE e shpallur fitues “ENGROUP” Sh.P.K. në sigurimin e ofertës nga Kompania e Sigurimit SH. A. “ELSIG” në emër të “ENGRUP” SHPK për Kuvendin Komunal Lipjan ka shënuar Numri i brendshëm 613 020 045 521 e jo siç është shënuar në sigurimin e OE të shpallur fitues Nr. i prokurimit 613-20-2452-5-2-1

PËRGJIGJEJE NË PRETENDIMIN NR. 4, Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk qëndron sepse e OE e shpallur fitues “ENGROUP” Sh.P.K. në sigurimin e ofertës të bërë nga Kompania e Sigurimit SH.A. “ELSIG” në emër të “ENGRUP” SHPK për Kuvendin Komunal Lipjan titulli i aktivitetit të prokurimit Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Gadime me numër të prokurimit : 613-20-2452-5-2-1 dhe numër të brendshëm: 613 020 045 521 e të cilin në sigurimin e tenderit e ka shënuar 613-20-2452-5-2-1 nuk është gabim sepse në të dy numrat e ka shënuar numrin e prokurimit të këtij aktiviteti pra nuk ka shënuar numër tjetër .

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

PRETENDIMI NR.5 Lidhur me pretendimin e OE NNP ”CTA” SHPK Prishtinë - ankues se AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN - komisioni vlerësues se oferta e OE e shpallur fitues “ENGROUP” Sh.P.K. nuk i plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale KERKESA NGA AK Kërkesa 2. j) Min. 7 punëtor të certifikuar në lëmin e ndërtimit si Armirues, Murator, Molerues, Suvatim, Ngrohje, Hidroteknike dhe Elektroteknike. Dëshmia e kërkuar: Për piken J. Të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional. Për të gjithë punëtorët kërkohej kontratat e punës ose para kontratë për këtë projekt. Autoriteti kontraktues mban të drejtën e verifikimit të Certifikatave të kërkuara, OE e shpallur fitues “ENGROUP” Sh.P.K nuk ka dorëzuar certifikata siç është kërkuar në dosje të tenderit për punëtorët nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional por ka dorëzuar Diploma. nuk e plotëson kushtin e AK që OE duhet të dorëzojnë certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional

PËRGJIGJEJE NË PRETENDIMIN NR. 5, Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk qëndron sepse e OE e shpallur fitues “ENGROUP” Sh.P.K ka dorëzuar diplomat për punëtor i cili është Dokument që i jepet dikujt si dëshmi kur mbaron një shkollë të mesme Më poshtë po japim domethënien e tjalëve “Diplotnë” dhe “Certifikatë” të marr nga Fjalori i gjuhës së sotme Shqipe (ASHSH 2006) Diplomë Dokument zyrtar që i jepet dikujt si dëshmi kur mbaron një shkollë të lartë a të mesme profesionale ose një kurs të posaçëm. Diploma e universitetit. Diplomë agronomi (gjeologu, mjeku, mësuesi, tekniku). Me (pa) diplomë. Mori diplomën u

diplomua. Certifikatë f. sh. zyrt. - Shkresë, që e lëshon një zyrë për të dëshmuar vërtetësinë e një fakti ose të një veprimi zyrtar; dokument që e lëshon një shkollë a një kurs për të vërtetuar mbarimin e studimeve; vërtetim, dëshmi. Certifikatë lindjeje (martese, vdekjeje). Certifikatë e gjendjes civile (e gjendjes familjare).

Certifikatë e notave. Certifikatë vaksinimi. Certifikatë mjekësore. Certifikatë vobekësie. vjet. Dëshmi vobekësie. Lëshoj (marr, paraqit) një certifikatë. Pra diploma është dokument që tregon se ka mbaruar një shkollë të mesme profesionale ose një kurs të posaçëm Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit profesional: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa operatorit ekonomik ankues N.N.P. "CTA" SHPK Prishtinë të merret si e pa bazuar. Andaj dhe rekomandojmë që të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e autoriteti kontraktues për shpërblimin me kontratë.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 13.08.2020, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit profesional.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 11.08.2020, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit profesional

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbal mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues NNP "CTA sh.p.k." –Prishtinë se autoriteti kontraktues e ka eliminuar pa të drejt me arsyetimin se: "Tenderi juaj është eliminuar për arsye se të kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional përkatësisht të stafi profesional vendimin apo deklaratën për emërimin e menaxherit e keni në emër të inxhinierit të Diplomuar të ndërtimtarisë-drejtimin konstruktive, ndërsa sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me drejtimin e arkitekturës". Me tej, OE ankues shton se në si ofertues kemi caktuar menaxher të projektit

inxhinierin e ndërtimtarisë Zija MORINA që ka qenë një gabim minor që nuk paraqet devijim të madh sepse në listën e stafit kemi të prezantuar edhe inxhinierin e arkitekturës master të cilin mund ta caktojmë menjëherë të projektit. Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkojë informata shtesë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues NNP "CTA sh.p.k." –Prishtinë se autoriteti kontraktues e ka eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se: "Tenderi juaj është eliminuar për arsye se të kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional përkatësisht të stafi profesional licencën e gjeodetit e keni me afat të skaduar". Me tej, OE ankues shton se AK nuk ka respektuar Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik Neni 39. Sqarimi i Tenderëve pika 39.5 si dhe Neni 72 të LPP Dokumentacioni dhe informacioni shtesë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa e AK në njoftimin për kontratë në pikën III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: ka përcaktuar kërkesën 2. Stafin Profesional f) Një gjeodet bachelor apo master të jetë i pajisur edhe me licencë për matje gjeodezike, Dëshmia e kërkuar dokumentare; b) Për stafin profesional nga pika A. deri G. Të dëshmohen me CV të nënshkruar nga vet inxhinieri, diplomat, Kontratat e punës ose para kontratës për këtë projekt, licenca për gjeodet me validitet. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se siç po shihet AK ka kërkuar për anëtarin e stafit profesional gjeodet, për pos dokumentacionit tjetër dhe licencë për gjeodet të jetë me validitet ndërsa OE - ankues e ka dorëzuar licencën në emër të Muzafer Mustafa - inxhinier i gjeodezisë " LICENCA - për kryerjen e matjeve kadastrale në bazë të vendimit të komisionit për Licencim nr. L-GJ/299 dt. 27.03.2014, Numri i Licencës 09. Afati i skadimit të Licencës 23.03.2019, ndërsa data e njoftimit për kontratë ka qenë 01.06.2020 dhe Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data 23.06.2020 koha 14:00:00. Andaj, Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkojë informata shtesë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues NNP "CTA sh.p.k." –Prishtinë se autoriteti kontraktues e shpallur fitues OE që nuk i plotëson kriterin e kërkuar të Kapacitetit teknik dhe profesional Në njoftimin për kontratë dhe dosje tenderit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në shumën prej 370,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë (në rast të grupit (konzorciumit) lideri duhet të ketë së paku 60% të kërkesës). Me tej, OE ankues shton se gjatë shikimeve në listën e OE ENGRUP shpk të shpallur fitues kemi hasur në projekte jo të ngjashme të cilat i keni vlerësuar si projekte të ngjashme lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku aktiviteti i prokurimit i përket ndërtimit të lartë ndërsa kontratat prezantuese janë të ndërtimit të ulët. Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform

nenit 59 dhe 72 te LPP-se te kërkoj informata shtese dhe te krahasoj pozicionet e këtyre kontratave me ato ne paramasen e AK-se te dosjes se tenderit.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues NNP "CTA sh.p.k." –Prishtinë se OE i rekomanduar për kontratë "ENGROUP" Sh.P.K. në sigurimin e ofertës nga Kompania e Sigurimit SH. A. "ELSIG" në emër të "ENGRUP" SHPK për Kuvendin Komunal Lipjan ka shënuar Numri i brendshëm 613 020 045 521 e jo siç është shënuar në sigurimin e OE të shpallur fitues Nr. i prokurimit 613-20-2452-5-2-1. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk qëndron për faktin se OE i rekomanduar për kontratë "ENGROUP" Sh.P.K. në sigurimin e ofertës të bërë nga Kompania e Sigurimit SH.A. "ELSIG" në emër të "ENGRUP" SHPK për Kuvendin Komunal Lipjan titulli i aktivitetit të prokurimit "Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Gadime" me numër të prokurimit : 613-20-2452-5-2-1 dhe numër të brendshëm: 613 020 045 521 e të cilin në sigurimin e tenderit e ka shënuar 613-20-2452-5-2-1 nuk është gabim sepse në të dy numrat e ka shënuar numrin e prokurimit të këtij aktiviteti pra nuk ka shënuar numër tjetër.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues NNP "CTA sh.p.k." –Prishtinë se OE i rekomanduar për kontratë "ENGROUP" Sh.P.K. nuk i plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale KERKESA NGA AK Kërkesa 2. j) Min. 7 punëtor të certifikuar në lëmin e ndërtimit si Armirues, Murator, Molerues, Suvatim, Ngrohje, Hidroteknike dhe Elektroteknike. Dëshmia e kërkuar: Për piken J. Të dëshmohet me certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional. Për të gjithë punëtorët kërkohen kontratat e punës ose para kontratë për këtë projekt. Autoriteti kontraktues mban të drejtën e verifikimit të Certifikatave të kërkuara, OE e shpallur fitues "ENGROUP" Sh.P.K nuk ka dorëzuar certifikata siç është kërkuar në dosje të tenderit për punëtorët nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional por ka dorëzuar diploma. nuk e plotëson kushtin e AK që OE duhet të dorëzojnë certifikata të lëmisë së ndërtimit të lëshuara nga Qendrat e licencuara për aftësim profesional. Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se te kërkoj informata shtese se a janë te vlefshme këto diploma konform kërkesës se AK-se te shpallur ne njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenkovic

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Lipjan;
- 1x1 OE NNP "CTA sh.p.k." – Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.